



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI **STATISTIKOR**

Nr.1

Viti 2026

Tabela e Lëndës

- 1 KLSH përmes shifrave
- 2 Treguesit kryesorë të veprimtarisë audituese
- 3 Opinione/Mesazhe/Konkluzione auditimi
- 4 Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
- 5 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore
- 6 Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
- 7 KLSH në media
- 8 Aneksë

AKRONIME

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve


CEF - Qendra e Ekselencës në Ekonomi e Lubjanës

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

1. AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




** Për subjektet të cilat nuk kanë kthyer përgjigje mbi programet e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, Në këtë fazë, për qëllime raportimi, këto masa janë konsideruar "pranuar".

2. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

2.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar - prill 2026, ka vijuar punën audituese në zbatim të programit të miratuar me vendimin nr. 242, datë 17.12.2025, të Kryetarit të KLSH-së, ka zhvilluar 91 misione auditimi dhe evaduar 14 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



2.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Për periudhën janar - prill 2026, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 34 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë, drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër




2.3 Opinione/mesazhe/konkluzione, sipas llojit të auditimit

Bazuar në programin e veprimtarisë audituese të KLSH-së për periudhën e këtij katër mujori të vitit 2026, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka përfunduar kryerjen e 14 misionëve të auditimit, duke konkluduar në 16 opinione/mesazhe/konkluzione auditimi, si më poshtë:

- **5** opinione përputhshmërie;
- **2** opinione financiar;
- **1** mesazh në auditim performance;
- **8** konkluzione nga të cilat: **6** konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve, **1** në auditim përputhshmërie, **1** në auditim tematik.

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera		Total
	I modifikuar	I pamodifikur	Konkluzione	Mesazh	
Përputhshmërie	3	-	1	-	4
Të kombinuar nga të cilët:					
• <i>Financiar</i>	2	-	-	-	2
• <i>Përputhshmërie</i>	2	-	-	-	2
Performance	-	-	-	1	1
Tematik	-	-	1	-	1
Zbatim Rekomandimesh	-	-	6	-	6
Total	7	0	8	1	16

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në bazë të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinioni i dhënë mund të jetë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:


Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje


Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- të kualifikuar,
- të kundërt, ose
- refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



2.4 Rekomandimet sipas natyrës



2.4.1 Masa organizative

Gjatë periudhës janar - prill, për 14 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 131 masa organizative dhe 2 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:

Tabela nr. 2: Masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësim ligjor
Institucione të pavarura dhe qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	5	94	2
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	1	2	-
Shoqëri publike dhe me financim të huaj	1	18	-
Auditimet e performancës	7	17	-
TOTAL	14	131	2

2.4.2 Përmirësime ligjore

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2026, për 14 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime 2 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë:

 **Në fushën e mjedisit**, synohet për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore apo nënligjore, me qëllim që vendosja e masave administrative të mos kufizohet vetëm në “*paralajmërim*” në inspektimin e parë, por të garantohet zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në ligjet specifike sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes.

Të saktësohet në mënyrë të qartë kuadri ligjor dhe/ose në akte nënligjore, interpretimi dhe zbatimi i kësaj dispozite, duke përcaktuar raportin ndërmjet ligjit të përgjithshëm të inspektimit dhe ligjeve të posaçme, me qëllim shmangien e interpretimeve të ndryshme dhe sigurimin e një zbatimi të njëtrajtshëm nga strukturat inspektuese.

Gjithashtu, synohet rishikimi dhe harmonizimi i Urdhrave me aktet nënligjore në fuqi lidhur me afatet e shqyrtimit të ankimeve, me qëllim eliminimin e mospërputhjeve dhe garantimin e një kuadri të qartë dhe të unifikuar për zbatimin e procedurave administrative.

Në figurën më poshtë gjeni të paraqitur numrin e rekomandimeve për përmirësime ligjore, sipas subjekteve dhe temës përkatëse të auditimit:


Infografik nr. 5: Përmirësime ligjore



2.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë periudhës janar - prill 2026, janë dhënë 58 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total me vlerën 314,892 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 84,381 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 230,511 mijë lekë.

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare në buxhet sipas fushave kryesore (në '000 lekë)



Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar në fushën e shpenzimeve.

Në fushën e shpenzimeve, peshën më të madhe (97%) e zënë shkeljet e konstatuara përgjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve/kontratave në vlerën 81,443 mijë lekë (likuidime për punime të pakryera, mos llogaritje e kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit, punime jo në përputhje me specifikimet teknike, etj).

Problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen implementimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik.

Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/ përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj.

*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.3

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës janar - prill 2026, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ** në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 230,511 mijë lekë nga të cilat:

- 126,267 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 55% e totalit) janë evidentuar problematika të tjera në zërin “Të ardhura të tjera” si pasojë e moszbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga leja mjedisore. Këto problematika përfshijnë mosparaqitjen e raportimit vjetor, mungesën e dokumentacionit të vetëmonitorimit, si dhe mospagesën e tarifës vjetore gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit. Është konstatuar mosrespektim i kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi, si pasojë e të cilit nuk janë ndërmarrë masat administrative të parashikuara nga legjislacioni përkatës.
- 104,244 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 45% e totalit) si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve. Shkelje të konstatuara në praktikën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, të cilat nuk janë ekzekutuar vullnetarisht, pas marrjes së njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por është zbatuar nëpërmjet urdhrave të ekzekutimit të lëshuara nga përmbartues privatë në vlerën 59,943 mijë lekë ose rreth 57.5% e totalit në fushën e shpenzimeve.

Infografik nr. 7: Efektet negative financiare

Efekte negative	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Total
Në të Ardhura	-	126,267	126,267
Në Shpenzime	84,381	104,244	188,625
Total	84,381	230,511	314,892

**Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.4

Tabela më poshtë paraqet vlerën e dëmit ekonomik, menaxhimit jo efektiv të fondeve, dhe mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela 3: Efekte negative në buxhetin e shtetit, në mijë lekë

Efekte negative financiare	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Total
Shpenzime	84,381	104,244	188,625
Procedura prokurimi	99	200	299
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	2,938	25,504	28,442
Shpenzime operative		19,376	19,376
Zbatim punimesh	81,344	648	81,992
Shpenzime të tjera	-	58,515	58,515
Të ardhura	-	126,267	126,267
Të ardhura të tjera	-	126,267	126,267
Total	84,381	230,511	314,892

2.5 Masa disiplinore dhe administrative


2.5.1 Masa disiplinore

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 34 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 5 masa administrative dhe 29 masa disiplinore.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të KLSH-së dhe në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 29 masave disiplinore nga të cilat:

- 5 masa disiplinore sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58.
- 24 masa disiplinore sipas Kodit të Punës dhe Kontratës Kolektive apo Individuale të Punës (pasi për 3 masa, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).


Infografik nr. 8: Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës



2.5.2 Masa administrative

Bazuar në Ligjin Nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 5 masa administrative. Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH u ka kërkuar organeve respektive (APP, IMTV, institucionit përgjegjës sipas kuadrit ligjor përkatës) shqyrtimin dhe marrjen e 5 masave administrative, si në infografikun më poshtë:

Infografik nr. 9: Masat administrative sipas llojit





Pyetja Kryesore:

A ka siguruar qeveria shqiptare harmonizim, zbatim dhe monitorim efektiv të Objektivit 1 të OZHQ-ve për të arritur rezultate të matshme dhe të qëndrueshme në reduktimin e varfërisë?



Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve

Zhdukja e varfërisë në të gjitha format


Harmonizimi i Objektivit 1 të OZHQ-ve zhdukja e varfërisë në të gjitha format me strategjitë dhe programet kombëtare rezultojnë i paplotë, pasi mungon Korniza Kombëtare e Indikatorëve dhe dokumentet ekzistuese nuk sigurojnë lidhje të matshme me politikat. Gjithashtu, Udhërrëfyesi për arritjen e OZHQ-ve ende nuk është miratuar. Mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1 nuk kanë funksionuar. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) nuk funksionon ndërsa pjesa më e madhe e institucioneve qendrore dhe vendore nuk kanë struktura ose përgjegjësi të caktuar për OZHQ-të. Zbatimi i masave për arritjen e Objektivit 1 është pjesërisht efektiv, pasi mbi 40% e popullsisë është në rrezik për të qenë i varfër ose përjashtim social, ndërsa buxheti i alokuar për mbrojtjen sociale në vendin tonë është ndjeshëm më i ulët se mesatarja e vendeve të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar progres të qartë, të matshëm dhe të qëndrueshëm drejt arritjes së synimit për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha format e saj deri në vitin 2030.

4. NIVELI I PRANUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE

Gjatë këtij katërmujori, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 225 masa, nga të cilat: 2 janë përmirësime/ndryshime ligjore, 131 janë masa organizative, 58 masa me efekte negative për shkak të parregullsive dhe 34 masa disiplinore dhe administrative.

Nga total 225 masat, janë pranuar 223 ose 99% dhe nuk janë pranuar 2 masa.
Niveli i pranueshmërisë sipas llojit të rekomandimit, rezulton si më poshtë:

Infografik nr. 10: Pranueshmëria e masave sipas llojit



* sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

Shënim: Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar". Për subjektet, të cilat edhe pse kanë respektuar afatin 20 ditor në kthimin e përgjigjes, por në shkresë nuk shprehen mbi pranueshmërinë e masës, masa do të konsiderohet "e pranuar".

5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

5.1 STRUKTURA DHE ORGANIKA


Për katërmujorin e parë të vitit 2026, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore. Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 211 punonjës, nga të cilët 157 janë staf auditues (ose rreth 74,4% e numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 16 kryeauditues
- 35 auditues të lartë
- 80 auditues të parë
- 26 auditues të dytë

Gjatë kësaj periudhë, në KLSH:

- janë rekrutuar 9 punonjës të rinj sipas procedurave të ligjit të nëpunësit civil

Infografik nr. 11: Organizimi i Burimeve Njerëzore




5.2 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Për periudhën janar - prill 2026, u realizuan 36 tema trajnimesh, nga të cilat 4 të organizuara nga ASPA; 24 nga KLSH dhe 8 tema nga partnerët ndërkombëtarë si EUROSAT, SAI i Suedisë, SAI i Izrael, SAI i Perusë etj.

U trajnuan gjithsej 150 staf auditues, duke realizuar mesatarisht 9.5 ditë trajnimi/staf auditues ose 1432 ditë njerëz trajnimi për periudhën Janar - Prill.

Ndërsa janë realizuar 8.8 ditë ditë trajnimi për stafin jo-auditues ose 389 ditë njerëz trajnimi.


Gjatë kësaj periudhe rreth 56% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 44% e tyre on-line.



Ndër temat kryesore, objekt trajnimi gjatë këtij 4 mujsori, rendisim çështje që lidhen me:

- Mbi kuadrin rregullator ligjor, nënligjor, në fushën e pasurive të paluajtshme dhe ndikimi në regjistrimin e pasurive publike;
- Manuali i Auditimit të IT-së;
- Korniza e menaxhimit të cilësive dhe implementimi i saj në KLSH;
- Microsoft Teams – komunikim dhe bashkëpunim;
- KLSH trajnon për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, SoAQM;
- Siguria e informacionit sipas Standardeve Ndërkombëtare dhe Kombëtare;
- Përdorimi korrekt i Outlook 365 dhe menaxhimi i email-it;
- Trajnim mbi Rregulloren e Brendshme;
- Inteligjenca artificiale në auditim;
- Marrëdhëniet me publikun: përdorimi i teknikave për ndërtimin e imazhit dhe reputacionit të institucionit të KLSH-së.

Infografik nr. 12: Ditët e trajnimeve për stafin auditues dhe jo-auditues, për periudhën janar - prill 2026



*Objektivat vjetore për realizimin e diteve të trajnimit për stafin auditues dhe jo-auditues për vitin 2026, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 245, datë 29.12.2025 "Për miratimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2026".

6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM


Kontrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës janar - prill 2026, ka administruar 56 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave, kërkesave për informacion apo denoncimeve.

Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin.

Ndërkohë, ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet, për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar - prill 2026, ka trajtuar 5 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë dhe përfaqësues të medias si dhe 47 ankesa dhe 4 denoncime nga qytetarë. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH dhe janë përcjellë tek kërkuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Infografik nr. 13: Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH
Janar - Prill 2026



7. KLSH NË MEDIA

Gjatë periudhës janar – prill 2026, aktiviteti i KLSH-së ka gjetur një pasqyrim të gjerë në media, me 662 artikuj të publikuar gjithsej në shtypin e shkruar dhe në median audiovizive dhe online. Këto artikuj kanë trajtuar gjetjet e raporteve përfundimtare të auditimit dhe rekomandimet e dhëna për subjektet e audituara. Raportimet mediatike gjatë kësaj periudhe, referuar auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kanë adresuar disa nga sektorët më të ndjeshëm të administrimit publik, duke evidentuar problematika që lidhen me menaxhimin e fondeve publike, sigurinë ushqimore, shëndetin, mbrojtjen e mjedisit, arsimin, si edhe politikat sociale.

Ndër auditimet me më shumë impakt në media gjatë këtij viti kanë qenë:

Në fushën e shëndetësisë, auditimi i përputhshmërisë në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor evidentoi mangësi serioze në administrimin e fondeve, raste të abuzimit financiar, si edhe problematika që lidhen me qarkullimin dhe shitjen e barnave të skaduara. Në të njëjtën linjë, auditimi mbi efektivitetin dhe sigurinë e barnave identifikoi dobësi në sistemin e monitorimit, kontrollit dhe garantimit të cilësisë së barnave, duke ngritur shqetësime për sigurinë e medikamenteve që u ofrohen pacientëve.

Auditimi në Avokaturën e Shtetit evidentoi mangësi në mbrojtjen e interesave financiare të shtetit, vonesa në ndjekjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore, si dhe pasoja financiare që rëndojnë buxhetin publik.

Në sektorin e sigurisë ushqimore, auditimet në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) evidentuan dobësi në sistemin e kontrollit, koordinimit institucional dhe monitorimit të sigurisë ushqimore, duke theksuar nevojën për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe garantimit të standardeve.

Auditimi në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) nxori në pah mangësi në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit, duke evidentuar nevojën për rritjen e efektivitetit të kontrolleve dhe koordinimit institucional.

Raporti Vjetor i Performancës 2025 ofroi një panoramë të përgjithshme të veprimtarisë audituese të KLSH-së, duke evidentuar ndikimin e rekomandimeve në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, rritjen e transparencës dhe forcimin e llogaridhënies së institucioneve publike.

Në fushën e mjedisit, auditimi “Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz” evidentoi mangësi në monitorimin mjedisor dhe në masat për mbrojtjen e shëndetit të komunitetit, duke rikthyer në vëmendje problematikat që lidhen me ndotjen dhe pasojat e saj.

Një tjetër auditim me interes të lartë publik “Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në lumin e Lanës në Tiranë” konstatoi se, pavarësisht investimeve të konsiderueshme financiare, rezultatet në përmirësimin e gjendjes mjedisore kanë qenë të pamjaftueshme për shkak të mangësive në planifikim, koordinim dhe monitorim institucional.

7. KLSH NË MEDIA

Në sektorin e arsimit, auditimet “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar” dhe “Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla” evidentuan nevojën për forcimin e mekanizmave të mbështetjes së nxënësve, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe rritjen e efektivitetit të masave për garantimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës në institucionet arsimore.

Ndër auditimet me ndikim strategjik ishte edhe ai mbi “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”. Auditimi evidentoi se ndryshimet demografike, rënia e lindshmërisë dhe plakja e popullsisë nuk janë shoqëruar me politika afatgjata dhe planifikim të mjaftueshëm financiar, duke theksuar nevojën për masa të koordinuara për përballimin e sfidave demografike në vitet në vijim.

Abuzim financiar dhe shitje të ilaçeve të skaduara

Një raport i KLSH evidenton shkelje në shpërndarjen e barnave spitalore

Nga FAKTORI - 09/04/2024



Raporti: Mbi 4.1 mln vezë nga Serbia dhe Turqia hynë në Shqipëri me mangësi dokumentacioni dhe kontrole të paplota

Nga Orshereve | Përditësime 27 Mars 2024, 11:25



© Shqipëri! Skandal që rëktheu KLSH në Kuvend. Pse ministria hesht



Çfarë po hamë? Vetting: ISUV shpenzon miliona euro për analiza jashtë, ndërsa në vend s'ka kontroll për ushqimin. Tenderat e dyshimtë dhe skema që lë pa mbrojtje konsumatorin

14 PRILL 2024 09:08



Medetëza e tekstit

“Vendimet e Strasburgut nuk janë zbatuar” / KLSH: Rrezik për 180 milionë euro në arbitrazh (VIDEO)

Shqipëria nuk ka mundur të ekzekutojë disa nga vendimet e fituara në Gjykatën e Strasburgut duke humbur mbi 10 milionë euro të ardhura që duhet të shkonin në buxhet. Auditimi i KLSH zbulon se problemet financiare rëndohen edhe nga çështje humbjeje në arbitrazh me rreth 180 milionë euro.



Watch on YouTube

SIGURIA USHQIMORE NË ALARM, KLSH: PRODUKTE TË PAKONTROLLUARA NË TREG

-SOCIAL

Siguria ushqimore në alarm, KLSH: Produktet të pakontrolluara në treg

Produkte të pasigurt që qarkullojnë pa u ndaluar, kontrole të pjesshme dhe institucione që reagojnë me vonë. Një auditim i KLSH zbulon një sistem sigurie ushqimore që funksionon më shumë në letër sesa në praktikë, duke lënë konsumatorët të ekspozuar ndaj pesticidëve, produkteve të pakontrolluara dhe një zinxhiri ku gjurmueshmëria shpesh humbet.

March 28, 2024

Ida Komajaj

Auditimi më i fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (SAKU) ka nxjerrë në pah problemet serioze në mënyrën se si kontrollohet siguria ushqimore në Shqipëri, nga një zinxhir i dobët dhe jo efektiv që lejon produkte të pasigurt të qarkullojnë lirshëm në treg.

Në nga rastet më flagrante sipas auditit të KLSH lidhet me një njoftim të ardhur nga sistemi evropian i alarmit për ushqimin, IASFF. Ky sistem signalizoi praninë e një pesticidi të rrezikshëm, leucobacazole në luleshtrydhe, në nivele disa herë më normat e Bashkimit Evropian.

TOP NEWS

- 1 Autonomia spitalore pa rezultate: Mungesë aksesit dhe shërbime të mbingarkuara
- 2 Bregdeti 2025: Mies kaosit të çmimit dhe alarmit për sigurinë
- 3 Indeks i Shtetit: Kompartamenti merr besimin e investimeve në Shqipëri

SHQIPERIA PO ZBRAZET, POLITIKAT MBETEN NË LETËR

-SOCIAL

Shqipëria po zbrazet, politikat mbeten në letër

Shqipëria ka po humbet popullsinë me ritme alarmante, ndërsa politikat publike mbeten të fragmentuara dhe shpesh vërtet në letër. Një auditim i KLSH i zbulon mungesë strategjie, përdorim të dobët të fondëve dhe masa simbolike që nuk arrin të realitetin ekonomik të familjeve. Më tej, projektet shpesh mbeten të ndërhyrjeve të pagarta, vendi përballim me një krizë demografike pa drejtim të qartë.

March 28, 2024

Ida Komajaj

Në letër, Shqipëria ka plan, strategji dhe dokumente që synojnë të adresojnë një nga sfidat më serioze të vendit: moshimin dhe bukurjen e popullsisë. Në praktikë, sipas një auditimi të fundit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), kjo politika shpesh mbetet në fragmente, të pakontrolluara dhe, në shumë raste, të shpërdorura nga realiteti.

TOP NEWS

- 1 Autonomia spitalore pa rezultate: Mungesë aksesit dhe shërbime të mbingarkuara
- 2 Bregdeti 2025: Mies kaosit të çmimit dhe alarmit për sigurinë

7. KLSH NË MEDIA

Ekonomi

Abuzimet në shtet, KLSH zbuloi 270 mln euro dëm buxhetit në 2025-n! Tenderat 'thembra e Akilit', fiti me të njëjtat mangësi si të skualifikuarit

Vepimet arbitrare, abuzimet dhe shkelja e ligjit nga institucionet publike, sidomos në tendera, i kanë shkakto buxhetit të shtetit një dëm prej mbi 270 milionë eurosh vetëm vitin e kaluar. Shifra është konstatuar vetëm në auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka dorëzuar raportin vjetor në Kuvend. Një prej fushave me shka të mëdha janë tenderat të cilat KLSH, ku një pjesëmarës shpalltet fitues edhe pse ka të njëjtat mangësi si konk



Nafta që 'vret': Patos-Marinza shpërthen në sëmundje malinje

KLSH konstaton ndotje në nivele të larta në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz dhe sëmundje të shtuara malinje, kardiovaskulare dhe respiratore. Rrefimi i banorëve: "Frike për fëmijët". Të gjithë të lidhur me naftën për punësim, por edhe me sëmundje.

Ndërmë praput të shtëpisë, pusi 'i zi' nr. 1754-P, tanimë i izoluar me kapak betoni, është shenja që nuk hiqet lehtë për 71-vjeçaren dhe fëmijët e saj, të mëdhenj e të vegjël. "Këtu janë thujasë të gjithë me karbon në gjak. Ne bëjmë check up (analiza) dhe na del gjaku i dyshimtë. Nuk dimë si të veprojmë se moshat tona ikën, po kemi hallin e fëmijëve, brezat tanë, fëmijët e kopshteve, të shkollave, çfarë ajri do marrin ata këtu?" - ngre shqetësimin nëna 71-vjeçare.



LAJME VIDEO SPORT POP NEWS PROGRAME YOUTUBE TOP NEWS LIVE

SOCIAL 17 FIMET

300 shkolla pa shërbim psiko-social/ 93 mijë nxënës pa mbështetje, në shumë shkolla nuk ka psikologë

© 31/01/2025 12:40

f w t



Më shumë se për 300 shkolla në Shqipëri nuk ofrohet shërbimi psiko-social, arrin në përfundim Kontrolli i Lartë i Shtetit.




EKOFIN Media

KREU AKTUALITET EKONOMI BIZNES TRIGJE TURIZEM GRLEN TË TJERA

KLSH: Dështim sistematik në IKMT, të gjithë ish-drejtuesit 2020-2024 me shkelje ligjore

05.08 - MAJIS 18, 2025

AKTUALITET



Reporter.al

INVESTIGIME ANALIZA LAJME REPORTAZHE

TEMA: BELINDA BALLUKU EKON VELIAJ VETDING SPAK MJEDISI EDI RAMA

Kryetërgj - Investigime

Milionat për pastrimin e Lanës nga ujërat e zeza i mori lumi

Dështimi historik i qeverive shqiptare për t'i dhënë zgjidhje trajtimit të ujërave të ndotura të Tiranës, që shkarkohen në Lanë, ka sjellë dëme të mëdha mjedisore dhe financiare.

nga Nexela Derishti 08.11.19/02/2025

në Artikull kryesor, Artikull kryesor Investigime, Investigime, Mjedis

0



93 mijë nxënës pa psikologë e punonjës social në shkolla! Raporti i KLSH: 1 në 4 shkolla pa shërbim, të tjerat pa cilësi

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit nxjerr në pah mangësi serioze në shërbimin psiko-social në arsimin parauniversitar. Një në katër shkolla në vend nuk ka psikolog apo punonjës social, duke lënë mijëra nxënës pa mbështetje. KLSH evidenton se shërbimi funksionon kryesisht në mënyrë reaguese si dhe me probleme në kriteret e punësimit dhe kushtet infrastrukturore.



REPORT TV HD

Watch on YouTube

8. Aneke

Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr . Auditimesh	Pesha në %
I kombinuar	2	14%
Performance	1	7%
Përputhshmërie	4	29%
Tematik	1	7%
Zbatim rekomandimesh	6	43%
Total auditime	14	100%

Tabela 1.1: Misionet e auditimit në numër, sipas departamenteve

Departamenti	Nr . Auditimesh
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	5
Departamenti i Auditimit të Inst. të Sigurisë Shoqërive Publike & Investimeve të Huaja	1
Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike	1
Departamenti i Auditimit të Performancës	7
Total	14

Tabela 2: Opinione/mesazhe/konkluzione sipas llojit të auditimit

Lloji i Auditimit	Opinion i modifikuar financiar	Opinion i modifikuar përputhshmërie	Konkluzion	Mesazh	Total
Auditim i kombinuar	2	2			4
Auditim performance				1	1
Auditim përputhshmërie		3	1		4
Auditim tematik			1		1
Auditim i zbatimit rekomandimeve			6		6
Total	2	5	8	1	16

Tabela 2.1: Kualifikimi i opinioneve sipas llojit të auditimit

Lloji i Auditimit	I kualifikuar	I kundërt	Konkluzion	Mesazh	Refuzues	Total
Auditim i kombinuar	4					4
Auditim performance				1		1
Auditim përputhshmërie	1	1	1		1	4
Auditim tematik			1			1
Auditim i zbatimit rekomandimeve			6			6
Total	5	1	8	1	1	16

Tabela 2.1: Kualifikimi i opinioneve sipas subjekteve

Kualifikimi i opinioneve	I kualifikuar	I kundërt	Konkluzion	Mesazh	Refuzues	Total
I kombinuar	4					4
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	2					2
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	2					2
Performance				1		1
Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format				1		1
Përputhshmërie	1	1	1		1	4
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore		1				1
Autoriteti i Konkurrencës					1	1
Enti Rregullator i Energjisë	1					1
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit			1			1
Tematik			1			1
"Rikonstruksion i rrugës Tragjas", Bashkia Vlorë			1			1
Zbatim rekomandimesh			6			6
"Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve (gjashtëmujori i I-rë) "1. "Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit".			6			6

2. "Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim".						
3. "Zbatimi i Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike".						
4. "Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor psikiatrik".						
5. "Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri".						
6. "Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik".						
Total	5	1	8	1	1	16

Tabela 3: Masat organizative dhe përmirësimet ligjore, sipas subjekteve të audituara

Lloji i institucionit ku ushtrohet auditimi	Masa organizative
Institucione të pavarura	23
Autoriteti i Konkurrencës	5
Enti Rregullator i Ujit	18
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	108
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore	36
Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format	17
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	28
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	25
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	2
"Rikonstruksion i rrugës në Tragjas", Bashkia Vlorë	2
Lloji i institucionit ku ushtrohet auditimi	Përmirësime ligjore
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	2
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore	2
Total	133

Tabela 4: Vlera e efekteve negative (në'000)

Të ardhura/shpenzime	Dëm ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Total Efekte financiare (në mijë lekë)	Rekomandime Gjithsej
	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.		
Shpenzime	84,381	13	104,244	15	188,625	28
Të Ardhura	-	-	126,267	30	126,267	30
Total	84,381	13	230,511	45	314,892	58

Tabela 4.1: Vlera e efekteve negative (në'000), të grupuara sipas ndikimit në të ardhura dhe shpenzime dhe subjektet ku janë konstatuar efektet, (në '000 lekë)

Të ardhura/shpenzime	Dëm ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Total Efekte financiare (në mijë lekë)	Rekomandime Gjithsej
	Vlera (në mijë leke)	Rekomandim nr.	Vlera (në mijë leke)	Rekomandim nr.		
Shpenzime	84,381	13	104,244	15	188,625	28
"Rikonstruksion i rrugës në Tragjas", Bashkia Vlorë	15,046	2			15,046	2
Autoriteti i Konkurrencës	2,938	1			2,938	1
Enti Rregullator i Ujit			1,375	1	1,375	1
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	62,285	6	56,555	3	118,840	9
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	4,112	4	46,314	11	50,426	15
Të Ardhura			126,267	30	126,267	30
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore			93,632	29	93,632	29
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës			32,635	1	32,635	1
Total	84,381	13	230,511	45	314,892	58

Tabela 4.2: Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas fushave kryesore (në '000 lekë)

Efektet Negative	Dëm ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Total Efekte financiare (në mijë lekë)	Rekomandime Gjithsej
	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.		
Shpenzime	84,381	13	104,244	15	188,625	28
Procedura prokurimi	99	1	200	3	298	4
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	99	1	200	3	298	4
Shpenzime operative			19,376	2	19,376	2
Enti Rregullator i Ujit			1,375	1	1,375	1

Efektet Negative	Dëm ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Total Efekte financiare (në mijë lekë)	Rekomandime Gjithsej
	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.		
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës			18,001	1	18,001	1
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	2,938	1	25,504	4	28,443	5
Autoriteti i Konkurrencës	2,938	1			2,938	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës			25,504	4	25,504	4
Shpenzime të tjera			58,515	5	58,515	5
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit			55,907	2	55,907	2
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës			2,608	3	2,608	3
Zbatim punimesh	81,344	11	648	1	81,992	12
"Rikonstrukcion i rrugës në Tragjas", Bashkia Vlorë	15,046	2			15,046	2
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	62,285	6	648	1	62,933	7
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	4,014	3			4,014	3
Të Ardhura			126,267	30	126,267	30
Të Ardhura të tjera			126,267	30	126,267	30
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore			93,632	29	93,632	29
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës			32,635	1	32,635	1
Total	84,381	13	230,511	45	314,892	58

Tabela 4.3: Vlera e dëmit ekonomik, sipas subjekteve/temës dhe fushës ku është konstatuar dëmi (në '000 lekë)

Dëm ekonomik sipas fushave	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.
Shpenzime	84,381	13
Procedura prokurimi	99	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	99	1
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	2,938	1
Autoriteti i Konkurrencës	2,938	1
Zbatim punimesh	81,344	11
"Rikonstrukcion i rrugës në Tragjas", Bashkia Vlorë	15,046	2
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	62,285	6
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	4,014	3
Total	84,381	13

Tabela 4.4: Vlera e menaxhimit joefektiv të fondeve, sipas fushës dhe subjekteve/temës ku është konstatuar dëmi (në '000 lekë)

Menaxhim jo efektiv	Vlera (në mijë lekë)	Rekomandim nr.
Shpenzime	104,244	15
Procedura prokurimi	200	3
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	200	3
Shpenzime operative	19,376	2
Enti Rregullator i Ujit	1,375	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	18,001	1
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	25,504	4
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	25,504	4
Shpenzime të tjera	58,515	5
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	55,907	2
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	2,608	3
Zbatim punimesh	648	1
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	648	1
Të Ardhura	126,267	30
Të Ardhura të tjera	126,267	30
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore	93,632	29
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	32,635	1
Total	230,511	45

Tabela 5: Masa Disiplinore dhe administrative sipas kuadrit ligjor përkatës

Masa Disiplinore/Administrative	Masa Administrative	Masa Disiplinore	Total
APP	1		1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	1		1
IMTV Inspektoratit Ndërtimor, Urbanistik	4		4
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	4		4
Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)		5	5
Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore		2	2
Autoriteti i Konkurrencës		1	1
Enti Rregullator i Ujit		1	1
Ish Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit		1	1
Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës		24	24
Enti Rregullator i Ujit		1	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës		23	23
Total	5	29	34

Buletini Statistikor Viti 2026

Të dhënat statistikore janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe janë përpunuar nga Sektori i Statistikave

Buletini Statistikor, janar - prill 2026 është ideuar dhe përgatitur nga Sektori i Statistikave.

Marzhi i gabimit të lejuar në këtë analizë statistikore është përcaktuar në nivelin 5%, duke reflektuar një nivel të pranueshëm të pasigurisë statistikore, në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ky nivel është në përputhje me standardet e pranura nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO 3534-1:2006) dhe udhëzimet statistikore të OECD-së, të cilat rekomandojnë përdorimin e marzheve të gabimit të tilla në studimet me një shkallë të lartë të saktësisë.

© Kontrolli i Lartë i Shtetit

Materiali i paraqitur në këtë dokument i nënshtrohet të drejtës së autorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Materiali mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, përkatësisht riprodhim për kërkime, studime private ose për qarkullim të brendshëm të kufizuar brenda një organizate për qëllime studimore dhe analitike.

Kopjimi për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me një njohje të mjaftueshme, të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër.



Rruga "Abdi
Toptani" Nr.1 Tiranë



klsh.org.al



+355 4 2247294



klsh@klsh.org.al